



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:181091  
Datë: 27.05.2024  
Numri i dokumentit: 05770195

Ac.nr.5749/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Naime Ahmeti, kryetare e kolegjit, Ylber Shurdhiqi dhe Adnan Konushevc, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit BKS me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson O.H., juriste tek e paditura, kundër të paditurit A.T. nga Podujeva, Rr. "...", të cilin sipas autorizimit e përfaqëson A.C., avokat nga Prishtina, me objekt kontesti rimbursim i dëmit, duke vendosur sipas ankesës së të autorizuarës së paditëses, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë, C.nr.245/2017 të datës 08.03.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 22.05.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

Refuzohet si e pathemeltë ankesa e të autorizuarës së paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit BKS me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë, C.nr.245/2017 i datës 08.03.2021, vërtetohet.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.245/2017 të datës 08.03.2021, në pikën një të dispozitivit ka refuzuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit BKS me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të: “detyrohet i padituri A.T. nga Podujeva, që paditëses në emër të rimbursimit të dëmit material të shkaktuar në aksidentin e dt.07.03.2013, të shkaktuar në Podujevë, në shumën prej 2,670.00 euro, më kamatën të cilën e paguajnë bankat afariste në R. Kosovës, për mjetet e deponuara për një vit, pa destinim të caktuar, duke filluar ti llogaritet nga dita e ngritjes së kësaj padie në gjykatë e deri në pagesën definitive, si dhe shumën e aprovuar i padituri detyrohet t’ia paguaj paditëses në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit me dhunë”. Në pikën dy, ka detyruar paditësen që të paguaj shumën prej 100.00 euro, palës së paditur për përpilimin e përgjigjes në

padi, në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin të përmbartimit me dhunë.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur e autorizuara e paditëses, për shkak të shkeljes dispozitive të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim për Gjykatën e Apelit, ta aprovoj në tërësi ankesën, ta prish në tërësi si të pabazuar aktgjykimin e atakuar dhe lëndën t'a kthej në rigjykim në shkallën e parë.

Përgjigje në ankesë ka ushtruar i autorizuari i të paditurit duke i kundërshtuar pretendimet ankimore, me propozim që Gjykata e Apelit të refuzoj ankesën e paditëses si të pabazuar dhe aktgjykimin e atakuar C.nr.245/17, të vërtetoj.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar dhe komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së neneve 194 dhe 195.1, pika (d), lidhur me nenin 200, të LPK-së, ka gjetur se:

-Ankesa është e pathemeltë

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, me padinë e parashtruar në gjykatën e shkallës së parë, me datën 24.04.2017, ka kërkuar që të detyrohet i padituri për rimbursimin e dëmit material në shumën prej 2,670.00 euro. Në përgjigje në padi i autorizuari i të paditurit ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë për shkak të parashkrimit duke propozuar që e njëjta të refuzohet si të pabazuar.

Duke vepruar sipas padisë, gjykata e shkallës së parë pa mbajtur seancën përgatitore ka vendosur për refuzimin e kërkesëpadisë së paditëses për shkak të parashkrimit duke u bazuar në dispozitën e nenit 357 dhe 362 të LMD-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata e Apelit vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitive të procedurës kontestimore nga neni 181 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Kolegji i Gjykatës së Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar për shkak të parashkrimit, pasi që duke u bazuar në dispozitën e nenit 357, paragrafi 1 të LMD-së, përcaktohet se: “*Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri (3) vite nga data kur i dëmtuari ka marrë dijëni për dëmin dhe për personin, i cili e ka shkaktuar dëmin*”, ndërsa me nenin 362, paragrafi 3 të LMD-së, përcaktohet se: “*Kërkesat e siguruesit nga kontratat e sigurimit parashkruhen për tre (3) vjet*”. Në rastin konkret, ky afat i parashkrimit është afat subjektiv, që përbëhet nga dy fakte dhe atë: nga fakti kur i dëmtuari kupton për dëmin dhe nga fakti kur i dëmtuari kupton-mëson për personin i cili e ka shkaktuar dëmin. Sipas kërkesëpadisë së paditëses rezulton se një kërkesë e

tillë është e parashkruar pasi në rastin konkret paditësja dëmin personit të dëmtuar i ka paguaj me datën 30.04.2013, sipas ujdisë jashtëgjqësore nr.952/14 të datës 05.04.2013, në shumë prej 2,670.00 euro, dhe se nga data e pagesës (30.04.2013), ka filluar që të rrjedh afati i parashkrimit, ndërsa paditësja padinë në gjykatë e ka paraqitur me datën 24.04.2017, dhe se nga shkresat e lëndës rezulton se padia është paraqitur jashtë afatit 3 vjeçar të parashkrimit. Afati i parashkrimit është koha e caktuar me ligj në bazë të cilit mund të kërkohet ndonjë e drejtë dhe se pas kalimit të këtij afati, e drejta e kërkesës nuk mund të realizohet përmes rrugës gjyqësore.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndron pretendimi ankimor se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 181 dhe 182 të LPK-së, për të cilat pretendon pala ankuese. Aktgjykimi nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe në lidhshmëri me këtë dispozitiv i aktgjykimit është i qartë dhe arsyetimi përmban arsye të mjaftueshme për të gjitha faktet vendimtare, të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosur lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë.

Është i pabazuar pretendimi ankimor i paditëses sa i përket zbatimit të së drejtës materiale dhe faktit se padia civile është paraqitur në vitin 2015, pasi që nga shkresat e lëndës rezulton se padia në gjykatë është paraqitur me datën 24.04.2017, fakt ky i cili vërtetohet sipas vulës së pranimit nga ana e gjykatës së shkallës së parë me rastin e paraqitjes së padisë në gjykatë, ndërsa nga data kur paditësja ka bërë kompensimin e dëmit palës së dëmtuar e deri me paraqitjen e padisë kanë kaluar më shumë se tri vite, nga çka rezulton se padia e paditëses është e parashkruar dhe se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale kur ka refuzuar padinë për shkak të parashkrimit.

Më tutje, gjykata e shkallës së dytë e ka vërtetuar edhe vendimin e gjykatës së shkallës së parë lidhur shpenzimet procedurale, duke qenë se gjykata e shkallës së parë, me të drejtë është bazuar në nenin 452 të LPK-së.

Nga të gjitha arsyet e cekura në arsyetim të këtij aktgjykimi të shkallës së dytë, Gjykatës së Apelit i rezulton se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga nenet 194, 195, paragrafi 1, pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.5749/2021, me datë 22.05.2024

Kryetare e kolegjit  
Naime Ahmeti, d.v.